

## SHP KISELLA VODË



## Aksioni i realizuar humanitar

Më 23 tetor të këtij viti anëtarët e Shoqatës së pensionistëve Kisella Vodë kanë realizuar një aksion humanitar të ndihmuar nga Organizata ndërkombëtare "Hajde Maqedoni", me të cilën Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë para pak kohësh ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Qëllimi i aksionit ishte që të grumbullohen prodhime ushqimore dhe të njëjtat t'u ndahen familjeve të rrezikuara sociale. Nga Marrëveshja me Organizatën "Hajde Maqedoni", Shoqata e pensionistëve Kisella Vodë fitoi një shtand me shënimin "Ushqe 10000" dhe leje nga marketi Tineks, për vendosjen e po të njëjtit shtang para hyrjes së marketit. Aksioni i realizua në ditë tregu. Mbishkrimi "Ushqe 10000" tërhoqi vëmendje të madhe tek blerësit, të cilët parashtruan pyetje të shumta. Pensionistët e angazhuar para shtandit simpatik shpjegonin se po zhvillohet një aksion humanitar për grumbullimin e prodhimeve ushqimore që do të dhurohen familjeve me të ardhura të vogla. Ata rekomanduan që krahas për vete dhe familjeve të veta, njerëzit mund të denjojnë edhe për ata që janë rast social dhe për ata që janë të ardhura të ulëta. Mbishkrimi "Ushqe 10000" është simbolik dhe asocon në atë se ka familje dhe njerëz që jetojnë me mjete minimale dhe jo çdoherë kanë ushqim të mjaftueshëm, ndërsa në një shoqëri humane nuk duhet të ketë njerëz të uritur dhe të harruar. Shumë nga blerësit gjatë daljes nga marketi, dhuronin prodhime ushqimore si kontribut të tyre ndaj aksionit. Kështu u grumbullua sasi e madhe e miellit, sheqerit, orizit, pasta, mjete higjienike dhe të tjera. Këto prodhime pensionistët i paketuan në pako dhe ua dhuruan familjeve të rrezikuara sociale. Ai ishte një aksion i bukur dhe fisnik, i cili shumë familjeve të pensionistëve u dhuroi befasi dhe kënaqësi të madhe. Aksione të këtilla kishte në Gazi Babë, Gjorçe Petrov, në Manastir dhe në vende të tjera. LSHPM


Tani ai na tha se shtëpia e tij është si një muze me lugë të llojllojshme me shenjë nga e gjithë bota dhe janë mbi pesë mijë për të cilat disa koleksionistë kanë ofruar më shumë se njëzet mijë euro për të gjithë koleksionin

Prilep/Shkup – 17 nëntor - Njerëzit kanë një larmi pasionesh, pra hobi, dhe sigurisht që ato dalin në pah në këmbënguljen për të pasur sa më shumë sende të ndryshme prej atyre që grumbullohen. Disa mbledhin dhe kanë koleksione distinktivësh, disa pulla, zinxhirë çelësash, stilolapsa, ndërsa gazetari në pension, Miodrag Mickoviq ka koleksionin e tij, do të thoshim të pazakontë - ai mbledh lugë të vogla. Në koleksionin e tij në shtëpi ka mbi pesë mijë lugë të ndryshme nga e gjithë bota. Këtë gazetar të pensionuar e njohin më të moshuarit nga shkrimet e tij në gazeta dhe emisionet radiofonike, duke raportuar dhe shkruar për sportin, veçanërisht për ekipet e futbollit të ish-Jugosllavisë, e më pas të vendit tonë. Prej tyre mësojmë se nga kudo ka udhëtuar me ekipet sportive si gazetar, është furnizuar dhe ka blerë lugë të vogla. Ajo gjë ju bë atij një zakon i rregullt dhe ai u bë një koleksionist i pasionuar me shumë e shumë lugë të ndryshme.

Kush është Miodrag Mickoviq? Ai është gazetar sportiv në pension, i lindur në Prilep në vitin 1938, familja e tij është nga fshati Topolčan i Prilepit, ndërsa gjyshi i tij ka qenë mësues shumëvjeçar në këtë fshat. Ai rregullisht i përcillte

## SHP PRILEP

## HOBI I PAZAKONTË I GAZETARIT TË PENSIONUAR MIODRAG MICKOVIQ



ndeshjet e klubit të futbollit Pobeda të Prilepit, jo vetëm në Prilep, por edhe kudo ku luante ekipi dhe natyrisht shkruante, raportonte për to.

"Ideja për të mbledhur lugë të vogla erdhi rastësisht. Si gazetar sportiv, udhëtimi im i parë ishte në Budapest, ku duke zgjedhur suvenire të ndryshme, më "ranë" në sy lugët e vogla, ato më pëlqyen më shumë. Luga e parë ka simbolin e Budapestit - parlamentin buzë Danubit. Pas kësaj, bleva lugë të vogla në secilin udhëtim timin. Kështu fillova t'i mbledh dhe t'i ndërroj. Koleksioni im i lugëve filloi të mbu-

shej nga e gjithë bota, sepse i ndërroja me koleksionistë që mbledhin bileta për ndeshje sportive dhe sende të tjera, si distinktivë e të ngjashme. Unë kam një rrjet të tërë, çdo lugë në fund ka një shenjë se nga është, nga cili vend, qytet apo shtet. Kështu që tani koleksioni im ka mbi pesë mijë lugë të vogla të ndryshme nga e gjithë bota. Nuk ka vend nga u cili nuk kam lugë", tha Mickoviq.

Ai thotë se shpesh vjen në Prilep ku ka shumë miq, e sidomos sportdashës, të ekipit të futbollit Pobeda. "Me lojtarët dhe sportdashësit e këtij klubi kam shkua-

kudo ku ka luajtur skuadra dhe sigurisht kam mbledhur nga kudo, kam blerë lugë të vogla. Ndjehem si një banor "gjakpastër" i Prilepit, edhe pse ditët e pensionit i kaloj në Shkup. Unë shpesh vet mahnitem me koleksionin tim dhe e di për çdo lugë të vogël se si "ka arritur" në këtë koleksion. Unë korrespondoj dhe bashkëpunoj me shumë koleksionistë nga e gjithë bota. Lugët e fundit i mora nga një koleksionist nga Galapagos - me breshkë, nga Grenlanda - me eskimez, nga Havai me kurora me lule që vendosen në qafë. Lugët e çajit më dërgohen me postë. Ngarkesa e fundit me 30 lugë çaji kushtonte 20 dollarë, e paguar nga dërguesi nga Amerika, të cilit i kisha dërguar më parë diçka për zëvendësim. Është shtrenjtë. Ndosht që të paguaj edhe 1200 denarë për postë, varësisht nga është dërgesa. Është shtrenjtë, por kështu është kur njeriu dëshiron të jetë koleksionist", shton Mickoviq.

Tani ai na tha se shtëpia e tij është si një muze me lugë të llojllojshme me shenjë nga e gjithë bota dhe janë mbi pesë mijë për të cilat disa koleksionistë kanë ofruar më shumë se njëzet mijë euro për të gjithë koleksionin, por Mickoviq nuk i ka lënë ato pavarësisht shumës së parave. "Koleksionistët karakterizohen nga lidhjet me koleksionet e tyre. Është e vështirë të ndahesh prej tyre, as për shumë para", na tha në fund gazetari sportiv Miodrag Mickoviq. K. Risteski

## PROBISHTIP

## JAVA E KUJDESIT TË PERSONAVE TË MOSHUAR

Përveç para shtëpisë së të moshuarve, aktivitete të tilla ka pasur edhe në zonat rurale, ku ekipi ka pasur gjithmonë një mjek, infermiere dhe përfaqësues të Kryqit të Kuq

Probishtip, 17 nëntor - Sivjet, për shkak të pandemisë dhe masave të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë dhe rekomandimeve të Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, të gjitha aktivitetet janë reduktuar në sa më pak, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të pensionistëve dhe qytetarëve të tjerë. Udhëheqësia e SHP Probishtip vendosi që këtë vit t'i reduktojë aktivitetet në ndihmë humanitare për anëtarët e saj të



cilët janë në gjendje të palakmueshme financiare ose janë të sëmurë dhe të plogësht. Në këtë kontekst është marrë vendim që të ndahen mjetet vetanake dhe të ndihmohet me pako ushqimore. Kështu janë shpërndarë 50 pako me vlerë prej nga 600 denarë, që do të thotë se për këtë qëllim janë ndarë gjithsej 30.000 denarë. Një pjesë e paketave janë shpërndarë

në qytet, e disa në zonat rurale edhe për pensionistët e sëmurë dhe të plogësht.

Në shënimin e "Javës së kujdesit ndaj të moshuarve" morën pjesë edhe vullnetarë nga Kryqi i Kuq i Probishtipit. Ata organizuan matje të shtypjes së gjakut dhe sheqerit në gjak, si dhe dhanë këshilla nga mjekë vullnetarë në organizatë. Sipas sekretarit të Kryqit

të Kuq, ky aktivitet është zhvilluar në ambientet e shtëpisë së pensionistëve dhe në oborrin e shtëpisë. Gjithçka është bërë sipas rekomandimeve për mbrojtjen nga virusi korona duke mbajtur maska dhe mjete të tjera mbrojtëse.

Përveç para shtëpisë së të moshuarve, aktivitete të tilla ka pasur edhe në zonat rurale, ku ekipi ka pasur gjithmonë një mjek, infermiere dhe përfaqësues të Kryqit të Kuq. Në këto shtatë ditë janë vizituar disa fshatra të komunës fqinje të Kratovës. sepse në të njëjtën nuk ka organizatë të Kryqit të Kuq.

Kryetari i SHP Probishtip dhe Aktiviti i pensionistëve kishin planifikuar edhe aktivitete të tjera, por ato u shtynë për kohë më të mira.

"Java e kujdesit ndaj të moshuarve" festohet edhe në qytete të tjera dhe shoqata të pensionistëve anëtare të LSHPM. M. Zdravkovska